

## Njoftim për punësim

### Punonjës social pranë Qendrës Komunitare Multidisiplinare Rrashbull

|  |   |
|--|---|
| <b>Pozicioni i punës</b>                   | Punonjës Social   |
| <b>Periudha e kontraktimit</b>             | Janar–Dhjetor 2022  |
| <b>Projekti</b>                            | “Riintegrimi i qëndrueshëm socio-ekonomik i migrantëve të kthyer në Shqipëri” |
| <b>Koha</b>                                | 40 orë në javë  |
| <b>Zona e projektit</b>                    | Bashkia Durrës, NJA Rrashbull   |
| <b>Data e mundshme e fillimit të punës</b> | 25.01.2022  |
| <b>Lloji i kontratës</b>                   | <b>Kontratë Pune Individuale</b>  |

Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS në bashkëpunim me Terre des Hommes në Shqipëri kërkon të rekrutojë një punonjës social **në kuadër të projektit “Riintegrimi i qëndrueshëm socio-ekonomik i migrantëve të kthyer në Shqipëri”** financuar nga GIZ (programi Migracioni për Zhvillim) . Ai/ajo do të ketë për detyrë të zbatojë në kohë dhe me cilësi aktivitetet e projektit dhe ofrimin e mbështetjes ndaj familjeve vulnerabël, vecanërisht procesin e riintegritimit të familjeve të rikthyera nga emigracioni që i përkasin Bashkisë Durrës, NJA Rrashbull

#### **Rreth Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS**

**Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS** (shkurtimisht NISMA ARSIS) është një organizatë jofitimprurëse, e cila është themeluar në shkurt të vitit 2016. NISMA ARSIS është një aktor jo qeveritar me influencë në sektorin e shoqërisë civile në Shqipëri.

Misioni i NISMA ARSIS është të ofrojë shërbime dhe zgjidhje të qëndrueshme për individë dhe grupet më të marginalizuara në shoqërinë shqiptare me theks të veçantë në komunitetet Rome dhe Egjiptiane. NISMA ARSIS advokon dhe lobon në nivel lokal dhe qendror mbi çështjet e mbrojtjes së fëmijëve dhe të rinjve, zhvillimit dhe pjesëmarrjes, përmirësimit të kushteve social-ekonomike të familjeve të tyre dhe fuqizimit të kapaciteteve të shërbimit ofruesve, organizatave jofitimprurëse, profesionistëve dhe aktorëve të tjerë të cilët punojnë me fëmijët në situatë vulnerabël.

#### **Rreth Terre des Hommes, Misioni në Shqipëri**

Terre des hommes – Misioni në Shqipëri është organizatë jo-fitim prurëse që operon në Shqipëri që prej vitit 1993 në kuadër të fuqizimit të sistemit dhe mekanizmave të identifikimit, parandalimit dhe mbrojtjes së fëmijëve nga keqtrajtimi, shfrytëzimi, braktisja dhe trafikimi.

Tdh Albania po zbaton programe në fushën e migrimit dhe antitrafikimit, mbrojtjes së fëmijëve dhe drejtësisë për të miturit. Tdh Albania punon në partneritet të ngushtë me grupet e interesit kombëtare dhe lokale në mbrojtjen, zhvillimin dhe zbatimin e modeleve të shërbimit që synojnë të përmirësojnë mirëqenien e fëmijëve, të rinjve dhe familjeve në nevojë. Në këtë drejtim, programi i migrimit në Shqipëri po punon me disa partnerë në nivel kombëtar dhe lokal për të siguruar shërbime cilësore të riintegritimit për të kthyerit dhe promovimin e përfshirjes sociale të komuniteteve më të rrezikuara.

## **Përshkrimi i Projektit**

Projekti “**Riintegrimi i qëndrueshëm socio-ekonomik i migrantëve të kthyer në Shqipëri**” financuar nga GIZ dhe vënë në zbatim nga TDH dhe NISMA ARSIS në partneritet me Bashkinë Durrës është në kuadër të Programit Migracioni për Zhvillim. Ky projekt ka si qëllim të ofrojë dhe sigurojë shërbime dhe aktivitete riintegruese për komunitetin e njësisë administrative Rrashbull dhe jo vetëm me fokus familjet e rikthyera nga emigrimi. Të gjitha këto shërbime ofrohen pranë Qendrës komunitare multifunktionale në Rrashbull, me synim mbështetjen, fuqizimin dhe rintegrimimin e familjeve në kushte të pafavorshme socio-ekonomike, sidomos të fëmijëve dhe të rinjve nga familje të rikthyera nga emigracioni i pasigurt, përmes procesit të menaxhimit të rastit dhe koordinimit me institucionet vendore.

Nën mbështetjen dhe supervizionin e plotë të Kordinatorit të Qendrës dhe ekspertëve teknikë të Terre des Hommes, ***punonjësi social do të ketë këto përgjegjësi:***

- Të identifikojë dhe të vlerësojë përfituesit potencialë në mënyrë proaktive në bashkëpunim me aktorët lokalë dhe komunitetin sipas kritereve të përcaktuara në kuadrin e menaxhimit të rasteve të Tdh dhe NISMA, me fokus të veçantë në migrantët e kthyer;
- Të informojë dhe të këshillojë familjet në shërbimet dhe aktivitetet e Qendrës Komunitare dhe Multifunktionale, si dhe në shërbimet në nivel Bashkie, në mënyrë që ata të përfitojnë nga një mbështetje e integruar që u përgjigjet nevojave të tyre;
- Të organizojë dhe lehtësojë grupin multidisiplinar në qendër të procesit të vendimarrjes për planin individual të ndërhyrjes për familjen, ndërsa merr pjesë në grupin teknik shumë-sektorial për rastet e mbrojtjes së fëmijëve të organizuar nga Bashkia;
- Ndjek procesin e aprovimit dhe përfundon blerjen e mallrave në bashkëpunim të ngushtë me familjet e mbështetura, ndërsa siguron të dhëna dhe mbledh informacion shtesë për rastet kur kërkohet;
- Mbështet familjet me një qasje fuqizuese përmes zbatimit të planit individual të ndërhyrjes për familjen, duke i këshilluar vazhdimisht ato në bazë të nevojave specifike;
- Koordinon dhe monitoron zbatimin e planit individual të ndërhyrjes në qendër dhe jashtë qendrës, ndërsa bashkëpunon ngushtë me punonjësin për mbrojtjen e fëmijëve dhe drejtorinë e shërbimeve sociale në Bashki për rastet e mbrojtjes së fëmijëve;
- Kontribuon në zhvillimin e botimeve dhe materialeve të tjera promovuese që lidhen me aktivitetet e punës sociale ;
- Njeh dhe zbaton me profesionalizëm dokumentacionin e punës së organizatës (rregulloren e brendshme, politikat e stafit, politikën e mbrojtjes së fëmijëve, politikat e mbrojtjes kundrejt shfrytëzimit seksual dhe abuzimit, kodit të sjelljes, konventën e të drejtave të fëmijëve, dhe çdo dokument tjetër të brendshëm të organizatës për të cilin duhet të ketë djeni);

### **Kualifikimet:**

- Diplomë bachelor në degët Punë Sociale , Psikologji;
- Diplomë në master shkencor në profilet përkatëse (preferohet në çështje të fëmijëve dhe familjes, drejtimi klinik, apo që kanë lidhje);
- Kualifikime që lidhen me çështje të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve dhe familjeve;

### **Eksperiencat:**

- Të ketë experience pune mbi 3 vjet në sistemin e mbrojtjes së fëmijëve, shërbimet shoqërore dhe punës për fuqizimin e familjeve dhe komunitetit;
- Eksperienca të mëparshme në organizata partnere të shoqërisë civile (preferohet);
- Të jetë njohës shumë i mirë i paketës ligjore për politikat e mbrojtjes së fëmijëve;
- Të ketë eksperiencë në menaxhimin e rasteve;
- Aftësi shumë të mira komunikimi dhe nderveprimi në punën në grup;

- Njohuri shumë të mira të gjuhës shqipe dhe të gjuhës angleze;
- Aftësi shumë të mira të përdorimit të kompjuterit, paketa Microsoft Word, Excel, email, etj
  - Dëshirë dhe mundësi për të udhëtuar në terren;
  - Të kuptojë dhe të dakortësojë me misionin dhe qëllimin e Nisma ARSIS dhe Politikat të Mbrojtjes së të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri;

**Politikat e Mbrojtjes së Fëmijëve:** Të gjithë personat që punojnë me programet e Nisma ARSIS janë të detyruar të respektojnë politikat e mbrojtjes së fëmijëve, politikat e mbrojtjes nga abuzimi dhe shfrytëzimi seksual, rregulloren e brendshme të Nisma ARSIS, kodin e sjelljes, Legjislacionin e plotë për Mbrojtjen e Fëmijëve si dhe çdo dokument tjetër për të cilin duhet të ketë dijeni. Punonjësi social do të zhvillojë detyrën e tij në përputhje me Politikat e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Koventën e të drejtave të fëmijëve të nënshkruar nga TDH & NISMA ARSIS.

#### **Procedura e aplikimit:**

Personat e interesuar duhet të dergojnë së bashku me kërkesën për aplikim në email:

- një kopje të jetëshkrimit profesional (CV)
- një letër interesi

brenda datës 15 janar 2022 në [initiative.arsis@gmail.com](mailto:initiative.arsis@gmail.com), deri në mesnatë .

*Ju lutemi, në vemendjen tuaj që:*

- në subjekt të emailit ku dërgohet aplikimi të vendoset: **Aplikim për pozicionin e punonjësit social\_QKM Rrashbull**
- vetëm personat e përzgjedhur për intervistë do të kontaktohen.